



Pranimi / Dorezimi Prilazimi / Prilazje Received / Delivered	16.05.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	Di. Prct Di. Prct Prct No.	Shtetja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSPK	2839/2022		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.429/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.429/2022 të datës 27.04.2022 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Ministria e Financave Punës dhe Transfereve – Thesari i Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.429/2022 të datës 27.04.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 27.04.2022 ka parashtruar ankesë përmes e-mailit me numër protokollit 2454/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër Njesisë së Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës për mos plotësim të kushteve për lëvizje brenda kategorisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga ankuesja ka pranuar e-mailin e datës 28.04.2022 me të cilin ankuesja e ka tërheqë ankesën e parashtruar për pozitën “Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Borxhit Publik të datës 27.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.protokollit 2454/2022 të datës 27.04.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raport për verifikimin e të dhënave të aplikuesit nga Universiteti i Prishtinës e i datës 08.04.2022; Vërtetim me nr.12/1595 i datës 12.04.2022; Formular për mbrojtjen e punimit të diplomës master me numër 01/96 i datës 04.03.2022; E-mail nga për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 28.04.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar së ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankueses **epse:**

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja _____ më datë 27.04.2022 me numër protokolli 2454/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që ka plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë, mirëpo ankuesja më datë 28.04.2022 ankuesja ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 2489/2022, për tërheqjen e ankesës së datës 27.04.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa dhënë ndonjë arsye konkretet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në rrethanat e lartcekura, konstaton se meqenëse ankuesja me kërkesën e datës 28.04.2022 ka tërhequr ankesën e datës 27.04.2022, atëherë bazuar në dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"**, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt, administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.429/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Thesarin e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

